



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar më: Priljeno: 03.03.2023		
Njësia Jednica	Numr. Broj	Shtojca Dodatak
1-052/01-11392		



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

PROCESVERBALI
NGA KONSULTIMI PUBLIK –
RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR NDARJEN E
SUBVENCIONEVE 15Nr.011-43473
TË DATËS 28.06.2019

**PROCESVERBALI
NGA KONSULTIMI PUBLIK – RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE 15Nr.011-43473 TË DATËS 28.06.2019**

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739 e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore në bashkëpunim me sektorin për marëdhënie me publikun kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Propozim Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve 15/Nr.011-43473 të datës 28.06.2019

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Propozim Rregullorja si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Me datë.10.02.2023 është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit Propozim Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve 15/Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2023/02/22NJOFTIM-PER-DEBAT-PUBLIK-1.pdf>

PROCESVERBALI
NGA KONSULTIMI PUBLIK – RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE 15Nr.011-43473 TË DATËS
28.06.2019

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Më datë: 20.02.2022 mbahet konsultimi publik në sallën nr.2 në Komunën e Lipjanit.
Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:
Në ueb faqe:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/news/diskutim-publik-per-rregulloren-per-ndarjen-e-subvencioneve/>

Konsultimi publik realizuar në kohën e paraparë dhe filloi në orën 10:00

Këtë takim e shpalli të hapur Vlora Krasniqi, shefe e sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore, ku prezantoi zyrtarët hartues të Draft – Rregullores.

1.Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit

2.Islam Kaleshi, zyrtar ligjor

3.Valdete Muji, zyrtare ligjore

Me këtë rast, znj. Krasniqi para të pranishmëve ka prezantuar **Propozim Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve 15/Nr.011-43473 të datës 28.06.2019** me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse.



PROCESVERBALI
NGA KONSULTIMI PUBLIK – RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE 15Nr.011-43473 TË DATËS
28.06.2019

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Vlora Krasniqi- Përshëndetje të gjithëve, të nderuar mire se keni ardhur sot në këtë takim për të konsultuar Propozim Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve 15/Nr.011-43473 të datës 28.06.201. Kjo rregullore dhe ndryshimet e saj janë në konsultim publik që nga 20 janari e deri me 23 shkurt 2023. Të gjithë ju që dëshironi të jepni kritika dhe sugjerime atë mund ta bëni duke shënuar në adresat zyrtare të cekura në njoftim i cili është publik në ueb faqe dhe faqen zyrtare në facebook.



Të nderuar të pranishëm, Komuna e Lipjanit, konkretisht sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore ka përgatitur ndryshimet e kësaj Rregullore duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739 e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë.

Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë rregullore e cila pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës të muajit shkurt dhe kërkoj nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth dispozitave të kësaj Projekt Rregulloreje.

PROCESVERBALI
NGA KONSULTIMI PUBLIK – RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE 15Nr.011-43473 TË DATËS
28.06.2019

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Ndërsa, të pranishmit patën rastin të inkuadrohen në temë dhe të kërkojnë sqarime rreth këtij dokumenti.

Rrahim Krasniqi, kërkoj sqarime nga Komisioni për ndryshimet e propozuara te neni 9 kryesisht rreth subvencionimit të punës praktike .

Vlora Krasniqi: e informoj Rrahim Krasniqin se me qëllim të përkrahjes të rinjëve në kryerjen e praktikës profesionale është propozuar që puna praktike të subvencionohet brenda mundësive dhe kapaciteteve buxhetore të Komunës. Komenti u pranua plotësisht.

Hyra Bytyqi Shabani, kërkoj sqarime se a do të ketë krijim të lehtësirave për Grupin joformal të grave gjatë parashtrimit të kërkesave të ndryshme për subvencionim për realizimin e aktiviteteve të tyre.

Vlora Krasniqi: e sqaroi Hyra Bytyqin që Grupi joformal i grave mund të ketë lehtësira sidomos në subvencionet që ndahen përmes thirrjeve publike ku përparësi në kriteret e konkursit do të kenë gratë për realizimin e aktiviteteve të tyre . Komenti u pranua pjesërisht.

Gafurr Hetemi diskutoj rreth ndryshimeve të propozuar në nenin 9 për pagesën e shpërblimeve të kategorive të ndryshme të qytetarëve të cilët kanë arritur rezultate në fusha të ndryshme me interes për Komunën ose që kanë ndikuar në rritjen e performances së Komunës duke e vlerësuar të qëlluar këtë ndryshim.

Vlora Krasniqi: e sqaroi Gafurr Hetemin se në këtë kategori mund të shpërblehet secili qytetar i komunës pavarësisht nga pozita në rast se ka arritur rezultate të konsiderueshme në ndonjë fushë që është me interes për komunën apo ndikuar në ngritjen e performances së komunës apo fitimin e ndonjë çmimi. Ajo çka u kërkuar sqarim nga komentuesi veç se ishte përfshirë vetëm se kishte nevojë për sqarim të dispozitës . Komenti u pranua plotësisht.

PROCESVERBALI
NGA KONSULTIMI PUBLIK – RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE 15Nr.011-43473 TË DATËS
28.06.2019

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Vlora Krasniqi, iu dha sqarime edhe të tjerëve që ishin prezent rreth kërkesave kryesisht të karakterit sqarues, ndërsa takimi u mbyll në ora 11:30

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	30 ditë pranohen	16
2. Publikimi në ueb faqe	30 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **16** pjesëmarrës, prej tyre **9** femra dhe **7** meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari
Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike

